

SHOQERIA TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"FLUZER COMPANY" SHPK

DURRES - SHQIPERI

AKT THEMELIMI

Ne Durres, sot me daten **13 Janar 2020** dymije e njëzete) dite e Hene, une shtetasi **Z.FLUTURIM ZERA**, atesia Pellumb, amesia Shkendije, i datelindjes 07.05.1968, shtetas shqipetar, lindur ne Dobërçan dhe banues ne Durres, identitet qe verifikohet me Leternjoftimin ID 035289673/G80507168P me afat deri me 09.03.2025 bazuar ne:

- * Vullnetin tim te lire, te plote, te singerte dhe ne inisiativen e lire private,
- * Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
- * Ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",
- * Ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit"

Me anen e ketij Akti Themelimi, krijoj Shoqerine tregtare ortak te vetem dhe me pergjegjesi te kufizuar **"FLUZER COMPANY"Shpk - Durres.**

NENI 1

Krijohet Shoqeria tregtare me emrin "**FLUZER COMPANY"Shpk**
emertim i cili do te jetë i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia Qendrore e Shoqerise eshte ne adresen Durres,Rr'Skenderbej ,Godina 382,Hytja 4 ,ZK 8514, Pasuria Nr.4/137+2-4 .

NENI 3

Shoqeria shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksonin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashtë shtetit.

Me Vendim te Asamblese mund te krijohen ose anullohen (ne rast se jane çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise, apo ne ndonje shtet tjeter te huaj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise, si dege apo perfaqesi dhe jashtë shtetit, krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte ne likuditet ne shumen **100.000 Lek** (njeqindemije) Lek i ndare ne **1 kuota** me vlerë nominative **1 kuota/100.000 Lek**, i formuar dhe nenshkruar Ortaku

1. Ortaku **FLUTURIM ZERA** kontribues me shumen **100.000 Lek** e barabarte me **1 Kuote** qe ze **100 %** te Kapitalit.

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjeter (te luajteshme apo te paluajteshme), te fituar ne rruge te ligjeshme.

Shoqeria perqigjet vetem me kapitalin e saj.

Fluturim Zera

[Handwritten signature]

Ortaku ka te drejte te transferoj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjeserisht ose teresisht kontributin e tij, perfshire fonde dhe vlerat e kontributit ne natyre bazuar ne te drejten qe i njeh Ligji "Per Investimet e Huaja".

Shoqeria dhe te tretet, respektive keto Transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 5

Me Vendim te Asamblese se Pergjithshme, ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen fonde te tjera duke perfshire dhe shtesa me ane te kapitalit ne natyre

NENI 6

Ortaku ka te drejte, qe pas shlyerjes se detyrimeve ndaj te treteve, detyrimeve ligjore te Sistemit te taksave dhe atij fiskal te ruaj Fondin Rezerve.

NENI 7

Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregetar ne keto Drejtime:

Investim dhe menaxhim në fushën e veprimtarisë ndertimore, per ndertimin e çdo lloj godine nje ose shumekateshe, civile, industriale, turistike, bujqësore, qendra biznesi, hotele, bar, restorante, investim dhe menaxhim per ndertimin e urave, çeljen dhe perfundimin e rrugeve te reja, çeljen dhe ushtrimin e aktivitetit te agjensive imobilare, investim, menaxhim dhe ndertime mbrojtese e punime sistemimi kunder gerryerjeve lumore, ligenore, importekspordin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te materialeve te gjithellojshem ndertimore, shoqeria te realizoje investime dhe sipermarrje ndertimore per ndertimin e hidrocentraleve dhe TEC-ve, me qellim per te realizuar prodhimin, transmetimin dhe shperndarje te energjise elektrike, si nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj dhe TEC-eve dhe rehabilitimit te tyre, eksport, import, shitblerje dhe prodhim te energjise elektrike, import, eksport dhe tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, artikujve ushqimore, blegtorale, bujqësore dhe te çdo lloj malli tjeter te lejuar per tregtim, marreveshje kontraktore me persona juridike vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit.

NENI 8

Me qellim arritjen e objektivit te shoqerise, shoqeria mund te merret me gjitheçka qe ka lidhje me objektin e saj, duke perm bushur te gjitha veprimet tregtare, per pasurite e paluajteshme dhe te luajteshme, financiare e bankare, edhe me veprime te zbuluara (perjashtuar mbledhjen e fitimit), duke pranuar pjesemarrjen ne fitim si dhe marrjen pjese ne shoqeri te tjera dhe sipermarrje me objekt veprimtarie analog, te ngjashem ose te lidhur me te, qofte direkt, qofte indirekt.

NENI 9

Me Vendim te Asamblese, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqipetar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjeter tregetare si brenda vendit dhe jashtë shtetit, te zgjeroj Objektin e veprimtarise se saj, te ndahet ne mirekuptim mes ortakeve ose ne rruge gjyqesore etj.

NENI 10

Organi me i larte Drejtues dhe i vetem Vendimor i Shoqerise eshte Mbledhja Asamblese se Pergjithshme e cila ushtron te gjitha kompetencat qe i njeh Ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare".

Ortaku mund t'ja delegoj kompetencat e tij nje ose me shume Administratoreve te caktuar me vendim te Asamblese ose dhe nje personi fizik shtetas shqipetar apo i huaj, mbi bazen e Prokures te bere me akt notarial.

Fluturim Zejo
Sefi

NENI 11

Me Vendim me shkrim te Asamblese caktohet, shkarkohet Administratori Pergjithshem brenda ose jashte bashkesise se Ortakerise si dhe Eksperti Kontabel i Autorizuar.

NENI 12

Administrator i Pergjithshem i Shoqerise, emerohet ortaku **Z. FLUTURIM ZERA**, i cili bazuar ne nenin 95 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", emerohet per nje periudhe kohe 5 vjet duke filluar ky afat nga data e sotme, me te drejte riperteritje.

NENI 13

Detajimi ne lidhje me problemet dhe administrimin e Kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative te tij, Transferimi, zmadhimi ose zvogelimi i Kapitalit, menyra e Drejimit Administrativ te Shoqerise, ajo e mbajtjes se llogarive dhe te Bilancit financiar, zgjerimi i Shoqerise ose shnderimi i saj ne nje forme tjeter Shoqerie Tregtare, bashkimi me Shoqeri te tjera tregetare vendase apo te Huaja, ndarja apo menyrat e falimentimit te saj dhe kalimit ne Likuidim etj, percaktohen ne menyre me te specifikuar ne Statutin e Shoqerise qe i bashkelidhet ketij Akti Themelimi.

NENI 14

Si rregull dhe per gjithisht Ortaku drejton dhe zhvillon aktivitetin tregetar te Shoqerise mbi bazen e mirekuptimit profesional dhe ligjor.

NENI 15

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare ne gjuhen **shqipe**, me permbajtje e vlera te njenjta juridike dhe pasi lexohet me ze, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i Shoqerise tregetare "**FLUZER COMPANY**" SH P K nenshruhet prej tij ne te gjitha ekzemplaret duke vene emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale.

ORTAKU VETEM THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"FLUZER COMPANY" SH P K

Miratues i ketij Akti Themelimi

Shtetasi shqipetar

Z. Fluturim Zera

